

Prof.Asoc.Dr. Klodjan Skënderaj

Ka përfunduar me rezultate maksimale (110/110) studimet universitare në vitin 2005, pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Gjenoves, Itali.

Në vitin 2013 ka përfunduar studimet e doktoratës në fushën e së drejtës së procedurës penale.

Prej vitit 2016 mban titullin “Profesor i Asociuar”.

Që prej vitit 2008 e në vazhdim është pedagog i lëndës “Procedurë Penale” pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës e prej vitit 2015 e në vazhdim është pedagog edhe në lëndën “Ekzekutimi i Vendimeve Penale” në këtë fakultet.

Është autor i librit “Ekzekutimi i Vendimeve Penale”, literaturë për studentët në Master Shkencor Penal dhe Master Profesional Penal, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Prej vitit 2018 e në vazhdim është ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës në Programin e Trajnimit Vazhdues. Gjithashtu është angazhuar si ekspert dhe në projekte të shoqatave të ndryshme me fokus ligjin procedural penal dhe atë material.

Prej shtatorit 2020 është anëtar i Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.

Është autor i një numri të madh punimesh shkencore të paraqitura në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe artikujve shkencorë të publikuar në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kontakt: klodjan.skenderaj@fdut.edu.al

klodjans@gmail.com

Zyra kati i 4, pranë Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës